

KAMBER KAMBERI

ESTETIKJA DHE DISA VEÇORI TË STILIT KADAREAN

Hyrje

Shkrimtari më i njohur i letërsisë së sotme shqipe, Ismail Kadare, njëkohësisht është edhe njëri nga shkrimtarët më të njohur të letërsisë së përbotshme bashkëkohore. Prandaj, sa herë që e përmendim këtë gjeni të letrave, pikësëpari mendja na shkon te veprat e tij, struktura e ndërtimit, personazhet, veprimet, kumtet, mesazhet dhe gjithsesi te veçoritë artistike. Dhe, rrallë ndodh të haset te ndonjë autor tjetër një përjasje letrare që mund të krahasohet me veçoritë e këtij autori. Një nxitje tjetër që të thellon vështrimin, shfaqet atëherë kur bëhen krahasime me veprat dhe personazhet e autorëve tjerë të letërsive botërore. E veçanta e tij artistike është lehtë e dallueshme, por sa më shumë të futesh në galerinë e tij krijuese, është e pashmangshme futja në sfera të shumta të imagjinatës për t'u kthyer së fundi në përfundimin se sferat e epërme zotërojnë vetëm gjenitë, ashtu si sovrani i letrave shqipe.

Ndërthurja e gjithë korpusit të veprave të tij, me mënyrën e rrëfimit dhe të veprimit, japin mozaikë interesant që së bashku ndërtojnë tablonë e madhe monumentale, të cilën di ta projektojë dhe realizojë vetëm imagjinata e një shkrimtari të pa shoq. Këtu janë personazhet e tij, të shumtë, interesant dhe të ndryshëm. Ata, jetojnë dhe veprojnë në tri botët në *Ferrin*, *Purgatorin* e *Parajsën*. Si veçori e jetës dhe veprimit në këto sfera, kufijtë ndonjëherë edhe thyhen. Disa nga personazhet e ndajnë Ferrin edhe me autorin përnjëherësh, sepse jeta tokësore e tij për një kohë ishte një ferr nën diktaturën në të cilën jetonte. Dhe këtë lloj *ferr*i, ai, mbase e shihte përditë dhe në të i vendoste personazhet e tij me të cilët bashkëjetonte, dhe nëpërmjet të cilëve jepte e merrte edhe kumte shprese. Parajsën, ndërkaq e krijonte vet me veprën e tij letrare si një demiurg i madh i kombit shqiptar, orë pas ore e ditë pas dite.

Në gjithë veprat e tij letrare, në strukturën e ndërtimit të tyre, do të shfaqet estetikja ku mund të nxirren shtresime të ndryshme, plane të ndryshme, krahasime, rangime e grupime të ndryshme letrare, shtrirje kohësh e vendesh, kozmogoni e kozmografi, lexime të ndryshme etj. Gjitha këto, që përbëjnë veprën tërësore të Kadaresë, të kujtojnë struktura të ndryshme artistike të cilat edhe nuk mund të përthekohen si tërësi. Prandaj, me një fokusim vështues, do të përkufizohem te estetikja dhe stili i veçantë, te struktura e përkryer e veprës së këtij autori, qoftë në poezi, apo në prozë, që krijon zonën interesante të *skënderbejadës*. Sepse kjo zonë letrare të përkujton strukturën gjithashtu të përkryer artistike të veprës së madhe të letërsisë botërore, “*Komedia Hyjnore*” e Dante Aligerit. Ky autor gjenial, veprimin dhe personazhet tij i çon në tri botë *Purgator*, *Parajsë* dhe *Ferr*. Dhe disa nga personazhet e kësaj trilogjie ishin dukur edhe si bashkëqytetar të të gjallëve edhe atje ku jetonte vetë Dante i internuar.

Një analogji letrare, haset edhe në letërsinë bashkëkohore shqipe, e cila shfaqet aq bukur te vepra e I. Kadaresë e sidomos te *skënderbejada* e tij. Këtë trini të madhe artistike e krijon edhe ky shkrimtar suprem i ditëve të sotme me personazhet e tij, por me mjete e teknika moderne. Në mënyrë të mrekullueshme dhe trajtim të veçantë, gjithmonë, pa i përmendur fjalët *ferr*, *parajsë*, *purgator* po duke i nënkuptuar ato si **Qiell** (parajsë), **Tokë** (purgator), **Nëntokë** (ferr).

Tri botë në veprën e Kadaresë

Personazhet e Kadaresë që lëvizin në gjithë veprat e tij, si traditë e përjetshme e letërsisë botërore, janë personazhe të identifikuara, por edhe të pa identifikuara, të pa emër, që veprojnë në një gjeografi të caktuar, në hapësira të ndryshme, herë të ngushta e herë të gjera. Të gjitha këto hapësira kanë emrin *tokë*.

Personazhe me emër që përshkruhen në *nëntokën* (nëntoka e Kadaresë) e tyre siç janë Skënderbeu tek “*Kështjella*”, Konstandini tek “*Kush e solli Doruntinën*”, Faraoni tek “*Piramida*” etj. Personazhe të pa identifikuar, paemër janë qindra ushtarë pushtues që kërkohen të gjenden në *nëntokën* shqiptare te “*Gjenerali i*

Ushtrisë Vdekur”, pashallarë, komandantë e ushtri me varre të humbura e edhe pa varre.

Qielli është hapësirë ku shfaqen e rishfaqen heronjtë, kryesisht si Skënderbeu. Nëpër qiell shfaqen edhe personazhe të paemër, që janë kryesisht simbol i së keqes, që ikin e s’dihet se ku shkojnë. Janë dhjetëra shpirtra që ikin nëpër shi, kërkojnë vende të largëta e ndoshta s’mbërrijnë kurrë atje. Janë shpirtrat e pushtuesve të vrarë në kohë të ndryshme në betejat arbërore. Autori ndalet kryesisht tek personazhe me emër si bie fjala Tursun Pashai tek *“Kështjella”*. Por ndërsa qielli është simbol i *Parajsës*, tek Kadare, kur është fjala për simbolizuesit e së keqes, qielli merr kuptim të dyfishtë në këtë rast: qielli është *ferr*, një udhëtim i shkurtër e pa adresë.

Në strukturën e madhe danteske, janë zonat e shtresuara, *Purgator*, *Parajsë* e *Ferr*, të cilat për ndryshim në strukturën kadareane këto shtresime do t’i quajmë *Tokë*, *Qiell*, dhe *Nëntokë*. Në këto shtresime, Kadare e vë edhe heroin, Gjergj Kastriot – Skënderbeun veçse me një optikë krejt tjetër, çka përbën një veçori të stilit të autorit.

Skënderbeu, prandaj shfaqet, në këto tri hapësira. Shfaqjet janë shumëfishe, dy herë, shumë herë, përjetësisht. Në një gjendje, dy gjendje e edhe shumë gjendje.

Toka te Skënderbeu

Skënderbeu, në penën e Kadaresë, në *Tokë* na jepet në disa gjendje e shumë pamje: si personazh real, tokësor, luftëtar, prijës, diplomat e hero, me vende e gjeografi të përcaktuara. Ai udhëheq betejat, lufton vet, fiton, ka marrëdhënie me emra të përcaktuar historikisht si te romani *“Kështjella”* te poezitë *Portreti i Skënderbeut*, *Vdekja e Skënderbeut* etj. Gjithashtu veprimi i kthimit të tij në *tokë* nga *nëntoka* shfaqet në tri pamje, si besëtytni, apo kult (*Ballada e zhvarrimit*), në formën e kujtesës dhe *si ringjallje*. Turqit i zhvarrosin eshtrat e Skënderbeut i thërrmojnë dhe bëjnë hajmali.¹

¹ “Historia nuk jep asgjë lidhur me këtë zhbërje të tij. U mor vetë me të qysh në gjallje? U morën ithtarët e tij? Përveç një legjende ushtarësh osmanë, përhapja e së cilës herë nixitej e herë ndëshkohej, sipas gjykimit se cili Kastriot do të ishte më i

Me këto eshtra enden në tri kontinente. Pra Skënderbeu është prapë në tokë, si besëtytni, apo si kult. Rikthimi në tokë në formën e kujtesës kombëtare vjen si: këngë, legjendë etj. E thënë nga autori se ai varrin (nëntokën) e ka në gjakun e shqiptarëve (*Ballada e zhvarrimit*). Rikthimi në formën e ringjalljes, nënkuptohet si nevojë historike. Këtë të kujton poezia *Terrori në Kosovë*, të shkruar në vitin 1981. Skënderbeu është pra i kudogjendshëm e i përherëshëm. Tokësor që vjen në forma të ndryshme nëpërmes të cilave heroi rikthehet në tokë nga nëntoka, por le të shohim artistikisht një rrugë tjetër të rikthimit. Kjo rrugë, rikthimi në *Tokë*, nisjen e ka nga *Qielli*.

*“Trupi i tij, porsi një shi i tmerrshëm
Përmbi qindra sheshe luftërash ra,
Tani toka avullon legjenda
Nga Ballkani, në Çanak-Kala”*²

Ai, Skënderbeu, kthehet në tokë në formën e shiut, për më saktë, rikthehet. Pra rikthehet nga qielli, sepse shiu, nga qielli bie. Dhe nuk rikthehet vetëm në tokën e vet, Arbri, rikthehet në tokë, *Nga Ballkani në Çanak-Kala*. Pra kthehet në dy trajta: si shi e si legjendë. E kjo marrëdhënie e ndërsjellë *Tokë-Qiell*, është pa kufij kohorë, është e përjetshme. Fjala tani, që përcakton kohën e sotme në vargun e tretë, e shfaq këtë ide. Fjala avullon nënkupton marrëdhënien e ndërsjellë *Tokë-Qiell*. Avulli që shkon në qiell e bie prapë në tokë, nënkupton pakohësinë, përjetësinë. Pra, Skënderbeu është përherë në tok ose rikthehet në tokë. Figurativisht rikthimi në tokë, është prania e tij si pjesë e përjetshme e të gjallëve që jetojnë mbi këtë tokë. Kadare flet për shqiptarët e gjallë në vjershën *Ballada e zhvarrimit* dhe i thotë Heroit: *“Ti, n gjak të tyre varrin ke”*.³ Pra, të gjallët jetojnë mbi këtë tokë e në gjakun e tyre, edhe Skënderbeu.

Tek Dante Aligeri, nëntoka është *Ferri*. Fjala *ferr*, nuk mund të

rrezikshëm, ai i qenë, apo i pa qenë, trup apo shpirt, asnjë kronikë tjetër nuk e ka shpjeguar dot misterin”.

I. Kadare, *Mosmarrëveshja*, Onufri, Tiranë, 2012, f. 136-137.

² I. Kadare, *Koha*, N. Frashëri, Tiranë 1976, f. 31.

³ Vepra e cituar, f. 31.

merret me mend kur flitet për Skënderbeun në veprën e I. Kadaresë, përmendet vetëm fjala *nëntokë*. Në trikohësinë e Skënderbeut, *nëntoka*, zë kohën dhe vendin më të pakët. Heroi *jeton* vetëm pak kohë në *nëntokë*, në varrin e tokësorëve. Më pas e zhvarrosin dhe ai merr dy emra të tjerë: *Tokë e Qiell* dhe këtë përjetësisht. *Nëntoka* s'përmendet më kurrë, ajo s'është vendi i tij. Prandaj edhe Kadare, i kushton *nëntokës së Skënderbeut* vargjet më të pakta, vëmendjen dhe kohën më të pakët.

Qielli i Skënderbeut

Në veprën e Kadaresë, Skënderbeu duke qenë më shumë tokësor, pak ose aspak nëntokësor, shfaqet përgjithnjë qiellor. Qielli në raport me Skënderbeun, si përmasë e tretë *dantesko-kadarejane* shfaqet në disa kohë e në disa trajta. Si kohë e parë e trajtë e parë, është gjallja e Skënderbeut. Sa ishte gjallë Skënderbeu, ishte *qiell*, thotë Kadare:

*“Si ditë e plotë ai shtjellej
Me re dhe erë mbi atdhe”⁴*

Pra ishte *qiell*, se dita nga qielli vjen. *Si ditë e plotë*, duke nënkuptuar edhe gjysmën tjetër, pjesën e natës. Ai, është ditë e plotë që *shtjellet* mbi atdhe.

Si kohë e dytë, trajtë e dytë, është koha e pasvdekjes, trajta e shiut. Skënderbeu, kthehet në shi, që *shtjellet* e *jeton* qiejve dhe bie herë pas here në tokë, pra është *qiellor*. Në trajtën e dytë, avullon nga toka e jeton në qiell në trajtën e legjendës. Binomi avull-legjendë, prapë e ka hapësirën në qiell.

Koha e tretë, prapë lidhet me qiellin por është e përcaktuar, pra është gjithëkohësia, pamatësia, përjetësia e heroit. Siç janë të pamatura, të pakohë e të përjetshme avujt e shirat, kështu është edhe sinonimi i tyre *Skënderbe*. I pavdekshëm si qiejt edhe i rikthyeshëm, nënkupton autori. Kështu, me mjete të tjera, moderne, Kadare, plotëson tri botët e *Komedisë Hyjnore* të Dante Aligerit: *Tokën*, *Qiellin* e *Nëntokën*. Sigurisht me mesazhe ndryshe, personazhe të tjera, por shpeshherë edhe të përafërta.

⁴ Vepra e cituar, f. 19.

Koha e katërt, është qielli brenda njeriut. Qiellin, si një hapësirë të pamatur, mund ta nxë edhe shpirti i njeriut, siç e nxë legjendën. Sepse e ka thënë Kadare në një varg */Tani toka avullon legjenda/*. Dhe kështu po e përsërisim edhe ne, se legjenda jeton vetëm në shpirtin e njerëzve. Po legjenda avull shkon në qiell, e duke qenë pjesë e shpirtit të njerëzve dhe vetëdijes së tyre, legjenda e presupozon shpirtin e njeriut si një qiell. Pra, qielli i katërt i Skënderbeut, është shpirti i njeriut shqiptar të gjithëkohshëm. Kështu, ai, ka katër qiej, apo katër forma në qiell për Skënderbeun. Po si një formulë e lashtë shqiptare, duket e marrë nga librat e shenjtë, bën fjalë për *“shtatë palë tokë e shtatë palë qiej”*. Pra, Skënderbeu ka edhe disa palë tokë e disa palë qiej si hapësirë të tij.

Nocionet kohë e hapësirë dhe thyerja e kufijve të tyre

Në veprat e përmendura, Ismail Kadare, kohën dhe hapësirën i përdor në shumë mënyra dhe në shumë funksione. Me to, ai, luan në forma të ndryshme, i thyen kufijtë e tyre. Po me këto, portretizon personazhin, thekson mesazhet që synon të përçojë tek lexuesi dhe metaforizon idetë. Kështu në tri kohë e vendos Skënderbeun në poezitë e tij *jeta, vdekja dhe pasvdekja*.

Brenda nocionit kohë e hapësirë që përdor poeti, ka një shumëkuptimësi dhe lexuesi mund të gjejë brenda një fjale një shumësi figurash stilistike. Pra interpretimi mund të bëhet në shumë mënyra. Poezinë *“Portreti i Skënderbeut”* e hap me këto dy vargje që kanë brenda edhe kohën, edhe hapësirën */ Si ditë e plotë ai shtjellej, / Me re dhe erë mbi atdhe/*.

Dita është koha, atdheu, është hapësira gjeografike. Dita si kohë astronomike këtu merr vlerën edhe të metafizikës edhe të simbolit dhe shërben edhe për të krijuar kontrastin. Dita simbolizon dritën, shpresën, të mirën. Është në kontrast me natën që sillnin pushtuesit. Është edhe krahasim, sepse Heroi krahasohet me ditën. Atdheu, si hapësirë gjeografike, gjithashtu ngërthen një shumësi kuptimesh e figurash. Dita dhe nata, janë si lajtmotiv i autorit në krijimet poetike me këtë temë, si:

“Çka mangut linte ditën Gjergji

*Plotësonte natën Skënderbeu*⁵

Po kështu tek Kështjella, koha në të cilën përshkruhen kështjellarët është kryesisht dita dhe koha në të cilën sulmohet kampi armik, është kryesisht nata. Vetë kampi armik përbën simbolikisht një natë. Simbolika është e qartë e edhe koha, shpeshherë nënkuptohet, sikurse tek dy vargje të poezisë, “*Portreti i Skënderbeut*”, / *Njëzet e katër luftëra bëri* / *Njëzet e katër-vdekje theu*./

Vetë numri 24 presupozon një shtrirje të gjatë kohore. Fjala vdekje gjithashtu presupozon një përmasë kohore dhe kështu e metaforizon idenë. Kjo kohë e nënkuptuar, i shërben autorit për të dhënë të madhërishtmen dhe heroiken, edhe si kategori estetike, edhe si mjete për të portretizuar heroin. Ndërsa hapësirën, autori e ka si mjet kryesor në trajtimin e figurës, të pafundme siç është e pafundme edhe liria, të cilën e simbolizon Gjergj Kastrioti.

Tek “*Kështjella*” ai, del që në fillim jashtë mureve të kështjellës dhe nga malet kryen aksionet luftarake. Atë nuk e nxë dot hapësira e një kështjelle, nënkuptohet nga autori. Me këtë mënyrë indirekte, autori jep madhështinë e personazhit. Pra, personazhin Gjergj, autori e sheh si një ditë të plotë mbi atdhe. Atdheu si hapësirë, duke e njëjtësuar me këtë hapësirë hiperbolike, autori çon tek lexuesi një shumëkuptimësi idesh edhe në poezi si, Vdekja e Skënderbeut. Autori i rikthehet këtij simboli, hapësirë, të përfaqësuar me fjalën atdhe. Gjymtyrët e heroit që po ftohen dalëngadalë në shtratin e vdekjes, i përqs me kufijtë e Arbrit.

Në poezinë “*Ballada e zhvarrimit*”, autori shkon më tej. Ai luan me hapësira ndërkontinentale. Heroi merr përmasa kozmike. Eshttrat e tij të zhvarrosura e të bëra hajmali tashmë shpërndahen në hapësirën e tri kontinenteve: Evropë, Azi, Afrikë. Vetë emrat gjeografikë që përmend autori në këtë poezi, përfaqësojnë këtë hapësirë. *Ballkan*, *Bosfor*, *Çanak-Kala*, janë disa nga emrat gjeografikë që përmendëm tek “*Ballada e zhvarrimit*”, gjeografi në të cilën janë shpërndarë eshttrat e Skënderbeut. Si përfundim, ritheksojmë se përdorimi i kohës e i hapësirës në një funksion

⁵ Vepra e cituar, f. 19.

shumëkuptimësh është një ndër veçoritë kryesore të stilit letrar të Ismail Kadaresë.

Numrat matematikor në funksion stilistik

N krijimet që i kushtohen Skënderbeut, Ismail Kadare ka si veçori të dukshme përdorimin e numrave matematikor në funksione stilistike. Edhe këtu ai përdor dy mënyra: përdorimi direkt i numrit shifror, nënkuptimi i numrit nëpërmes fjalës, ose fjalë që krijojnë numra. Veçanërisht i theksuar, ky përdorim artistik duket në poezinë “*Portreti i Skënderbeut*”. Numrat shifror më të përdorur janë 2 dhe 24. Veçanërisht 2 (dy) përdoret mjeshtërisht nga autori si mjet stilistik për ta portretizuar Skënderbeun, sikurse te poezia “*Portreti i Skënderbeut*”: /Dy brirë dhie kish mbi krye/ ose /Dy perandorë do godiste/, mandej, /Njëzet e katër luftëra bëri/, /Njëzet e katër vdekje theu/.

Gjithashtu, Heroi ka dy emra: Gjergj e Skënderbe, emblema e tij ka dy brirë dhie, Heroi ka thyer dy perandorë, ka bërë 24 luftëra dhe i ka fituar. Përmes kësaj, autori na kumton se Skënderbeu ka thyer 24 vdekje. Me këtë shkallëzim ngjites (nga 2 deri tek 24) autori portretizon mjeshtërisht personazhin dhe himnizon lavdinë e tij. Brenda kësaj poezie gjejmë edhe numra të tjerë, njëri i papërcaktuar, tjetri i nënkuptuar: “*Në mijëra varre ato u shtrinë*”, thotë Kadare për eshtrat e Heroit, ndërsa numri një jepet indirekt, nëpërmes fjalës të vetme në vargun e fundit, “Të vetme kish veç Shqipërinë”

Përveç ideve që mbartin, këta numra janë edhe figura stilistike, të pranëvëna me fjali të tjera që krijojnë simbolin, anaforën dhe personifikimin. Një nga numrat më të përfolur e ndoshta më simboliku është *treshi* që është numër simbolik, mitologjik e biblik: a) *lindja, jeta, vdekja* (te njeriu), b) *dje, sot, nesër* (tri përmasat e kohës), c) *Ati, Biri, Shpirti* (Trinia e shenjtë biblike), *Tri zana, Tri mrize* etj. (Mitologjia shqiptare).

Analiza do të vijonte gjatë, por i përmendëm këto fakte se I. Kadare, me figurën e Skënderbeut kështu krijon disa trini: 1) *Gjergj-Skënderbe-Atidhe*. 2) *Lindja-Shqipëria-Perëndimi*. 3) *Jeta-Vdekja-Përjetësia*. Prandaj, përfundimisht mund të thuhet se edhe me këtë veçori të stilit të vet, I. Kadare, pasuron stilistikën e ligjërit poetik

dhe sjellë risi poetike në letërsinë shqipe.

Tërësia e veprës si figurë artistike, shumëkuptimësia dhe shumëkohësia

Dihet se ndërtimi i çdo vepre arti e letërsie ka si mjet themelor figurën artistike, kështu veprat e Kadaresë, kanë një pasuri të madhe figurash. Studiues të ndryshëm kanë vënë re se në këtë lemë, ai është novator i madh i letërsisë shqipe. Simboli është një ndër mjetet (ndoshta themelor) i letërsisë moderne botërore, prandaj mendojmë se këtë mjet e ka kryesor edhe I. Kadare në veprën e tij, por tek krijimtaria e tij, vëmë re edhe një risi tjetër, shumë vepra të tij përbëjnë një figurë të vetme. Kështu për shembull mund të thuhet se i gjithë romani “*Kështjella*” përbën një simbol të vetëm. Ai, mund të interpretohet edhe si një metaforë e vetme. I gjithë portreti i Skënderbeut i dhënë edhe tek poezia me të njëjtin titull, përbën një simbol.

Brenda këtij imazhi, shfaqen edhe dy karakteristika të spikatura tek krijimtarisë së Kadaresë: *shumëkuptimësia, shumëkohësia*. Këto janë tipare të letërsive moderne. Kështu, vet simboli kështjellë, është i shumëkuptimshëm e i shumëkohshëm. Me fjalën *kështjellë* kuptojmë qëndresën, luftën, por edhe rrethimin, ngujimin, apo izolimin. Në romanin e Kadaresë, *kështjella* merr edhe një përmasë tjetër kuptimore: atë të një vendi të tërë, në rastin konkret të Shqipërisë. Në kohën kur u shkrua romani, Shqipëria ishte e izoluar. Studiuesit e kohës kanë vënë re se autori mbase, aludon tek koha aktuale e Shqipërisë, të gjysmës së dytë të shekullit XX, megjithëse ngjarjet e romanit “*Kështjella*” zhvillohen në shekullin XV. Pra ja si shfaqet bashkëkohësia. Është vënë re gjithashtu se te “*Pallati i ëndrrave*”, autori aludon për diktaturën komuniste në Shqipëri, ndonëse në leximin e pare ngjarjet ndodhin në Stamboll, shekuj të shkuar.

Pra, ka tema universale që s’i përkasin vetëm një kohe e një vendi, por shumë kohëve e shumë vendeve. Tema e lirisë, e qëndresës, e dinjitetit njerëzor etj., janë tema të gjithëkohëshme dhe u përkasin të gjitha vendeve, gjithë njerëzimit. Pikërisht këto tema janë boshti i këtyre veprave të Kadaresë.

Qëndresa, liria, dinjiteti i njeriut

Historia e shqiptarëve është nga më të veçantat e më tragjikut e popujve të Kontinentit të vjetër. Pushtime të gjata, luftëra të pandërprera, rrënime, vonesa historike etj. *Treqind kryengritje në katërqind vjet*, thotë Kadare në një poezi. Po ashtu, e kushtëzuar nga ky realitet ka qenë edhe jeta e prijësve shqiptarë, veçanërisht e Skënderbeut. Në 25 vjet të jetës së tij si prijës i arbërve, ai bëri 24 beteja, përsëri sipas poezisë së Kadaresë.

E pashoqe dhe e njohur në Evropë ishte edhe qëndresa e shqiptarëve, që ka rëndësi, për fatet dhe qytetërimin e Evropës. Ismail Kadare, me veprën e tij letrare, ka risjellë në kohën tonë shumë epoka, ka ribërë letrarisht historinë dhe temën e qëndresës e ka bosht themelor në një pjesë të madhe të veprës së tij. Dhe falë artit të tij të madh, kjo temë e ka bërë Kadarenë me individualitetin më të spikatur në letërsinë shqipe. Kur flitet për qëndresën, periudha kulmore e saj është pikërisht koha e Skënderbeut, dhe simboli i kësaj kohe është vetë Skënderbeu.

Në lëndën që na ofron vepra, vërejmë se I. Kadare, qëndresën e shqiptarëve e sheh në dy pamje: qëndresë kulturore, pra shpirtërore dhe qëndresën luftarake. Që herët, ai merret me temën e agresionit kulturor. Para se të ndodhte pushtimi turk, në Shqipëri u shfaqën turma dervishësh, që me ritet e veshjet e tyre të çuditshme, paralajmëronin diçka ogurzezë. Pastaj erdhën ferexhetë e më në fund ushtritë e pushtimi që synonin zhbërjen e gjithçkaje: të gjuhës, veshjes, dokeve, zakoneve, pra të krejt konstitucionit shpirtëror të shqiptarëve.

Është një pjesë e gjerë e veprës së Kadaresë që i kushtohet kësaj qëndrese, pra qëndresës kulturore. Në kontrast të fuqishëm me zymtësinë aziatike, autori vë gjuhën e bukur shqipe, veshjet plot dritë të shqiptarëve, legendat dhe eposin-e tyre, zakonet dhe sjelljet prej fisnikësh europian të shqiptarëve. Autori nënvizon idenë se është pikërisht kjo qëndresë që u mundësoi shqiptarëve mbijetesën. Rezistenca e vazhdueshme mbinjerëzore, shpeshherë edhe e pashpjegueshme se si i rezistuan asimilimit si rrezik i përhershëm. Edhe kur kështjellat prej guri të Arbërisë ranë / ...*kështjella e sintaksës / Su muar, se su muar*, / thotë autori në poezinë *Gjuha*

shqipe. Për të pasqyruar qëndresën, autori përdor një arsenal të tërë mjetesesh artistike. Bien në sy simboli, animizimi (shpirtëzimi i jofrymorëve) dhe personifikimi. Vetë *kështjella*, bie fjala, merr trajtën e një personazhi dhe bëhet qëndresë. Qëndresë bëhet kënga, vallja, veshjet etj., qëndresë është edhe lahuta. Sintaksa e gjuhës shqipe kthehet në kështjellë etj. Të gjitha këto elemente të natyrës e të kulturës materiale e shpirtërore, autori i shpirtëzon dhe u jep atributet e personazheve qëndrestarë.

Qëndresa dhe heroizmi i shqiptarëve jepet edhe në një mënyrë tjetër artistike: nëpërmes fjalëve të vëna në gojën e personazheve të huaj. Pra dhe kur mungon veprimi, si element artistik klasik për të përshkruar personazhin a fenomenin, autori e realizon motivin me mënyrën tjetër. Hamendjet, ankthi, shqetësimet, të folurat për shqiptarët etj. e përshkruajnë në mënyrë të tërthortë qëndresën e tyre.

Veprimi dhe personazhi, si mënyra tradicionale për të kumtuar ide dhe gjendje, janë të njohura në veprat e Kadaresë. Skënderbeu, kështjellarët, betejat, janë elemente që plotësojnë tablonë e madhe të qëndresës. Në përfundim mund të themi prandaj, se mesazhet që përçon Kadareja përmes motivit të qëndresës janë aktuale dhe i japin veprës së tij cilësinë themelore të veprës moderne: universalitetin, kohor e hapësinor.

Motivi i ringjalljes, kozmogonia, kozmografia dhe metafora

Motivin biblik të ringjalljes së Krishtit, e kanë përdorur letërsitë e të gjitha vendeve dhe të të gjitha kohëve. Jo rrallë, këto letërsi, bazuar në këtë motiv, kanë krijuar vepra të njëmendëta artistike dhe kanë përcjellë mesazhe të rëndësishme artistike që i kanë shërbyer kohës. Përveç motivit biblik, popuj të ndryshëm, motivin e ringjalljes e kanë në legjendat dhe eposet e tyre, para e pas Krishtit. Shqiptarët, këtë motiv e kanë në dy nga kryeveprat e trashëgimisë poetike gojore të folklorit të vet: Ringjallja e Kostandinit, për të mbrojtur besën e dhënë së motrës të martuar nëntë male larg dhe ringjallja e Mujit në Eposin e Kreshnikëve

Këtë motiv të trajtuar tek “*Kush e solli Doruntinën*”, Kadare e përsëritë në një formë të nënkuptuar, tek vjersha “*Terrori në*

Kosovë”, më 1981. Në këtë vjershë ai, ringjall Skënderbeun, në mënyrë metaforike. Skënderbeu përmendet vetëm në një varg, por në letërsinë botërore e në atë shqipe, jo rrallë një varg i vetëm bart mesazhin e një veprë të tërë. Le të kujtojmë sa për ilustrim Shekspirin tek Hamleti, me vargun “*Të rrosh a të mos rrosh, kjo është çështja*”, që përçon tek lexuesi gjithë filozofinë njerëzore të raportit jetë-vdekje.

Në këtë hulli, në njërin nga momentet më dramatike e më të diskutueshme të kombit shqiptar, Kadare i drejtohet me një varg të vetëm edhe njëherë figurës së Skënderbeut në vjershën, “*Terrori në Kosovë*”. Është viti 1981, në Kosovë ka terror. Studentët janë ngritur në demonstrata në Prishtinë dhe kërkojnë liri e dinjitet, Kosovën Republikë dhe përmes kësaj largimin e *mesjetës serbe*, sipas të gjitha kartave e dokumenteve ndërkombëtare. Por ka ndodhur një ringjallje e paralajmëruar e së keqes. Është ringjallur *lugatëria* shoviniste serbe me mite vrasare, car, knjazë etj. Gjithçka shtypet me dhunë e gjak. Inkuizicioni mesjetar, është i pranishëm në Kosovën e përgjakur. Por, kur bie shi vrasar, e kuçedrat bubullojnë, ngjallen edhe dragonjtë e dalin në sheshbeteja. Është ngjallur car Dushani serb, gjakatari, ardhacaku, gjuha e tij e mesjetës s’kuptohet, por ai ka një kod të lashtë të shkruar në ballë: krimin dhe gjakun. Po atëherë do të ringjallet antikrimi, çlirimtari, antigjaku, *arrin* Skënderbeu. Atë e ringjallë Kadare, vetëm me një varg, / *Se pas Dushanit, car të frikshëm, / Rrufeshëm Skënderbeu arrin* /. Po, a thua, ku është Skënderbeu, që duhet të arrijë rrufeshëm? Është kudo dhe njëkohsisht s’dihet ku është. Këtë, Kadare e ka thënë dikur me vargjet / *Ti në gjak të tyre, varrin ke, / O i mbeturi pa varr, o Skënderbe!* /

Pra heroi është tek çdo shqiptar dhe Kosova ku ndodh terrori është krejt shqiptare. Po, Skënderbeu, siç ka thënë Kadare, është në tri kontinente përnjëherësh. Koha s’pret, duhet të vijë rrufeshëm, sepse në Kosovë kanë mbërritur korbata: hetues, gjykatës, prokurorë. Mesjeta ngjallet si *lugatëri* e vjen në Kosovë, / *Dhe u kthye nata e Prishtinës/ / Në natë të Shën Bartolemeut/*

Termat *kozmoграфи, kozmogoni, e metaforë*, përbëjnë një trini në veprën e Kadaresë, posaçërisht kur flasim për Skënderbeun. Hëna të

përkujton emrin si *hënë*, Skënderbe. Dielli të përkujton emrin si *diell*, Gjergj. Nata, të kujton sulmet e Skënderbeut mbi kampin turk, që kryesisht i bënte natën. Dita të përkujton, ditën në ditarin e kështjellarëve. Europa ku ndahet me Azinë, të kujton qerret që ikin nëpër shi drejt Azisë, qerret e ushtrisë së mundur dhe Tursun Pashain e helmuar, apo të vetëhelmuar, tek romani "*Kështjella*".

Hënë, diell, qiell, yje, astrologë, fallxhorë etj., përbëjnë *kozmogoninë* tek Kadare. Kufijtë e thyer të kontinenteve, Europë-Azi, qerret që ikin nëpër shi, përbëjnë *kozmografinë*. Për Kadarenë, s'ka gjeografi kur bëhet fjalë për Skënderbeun, ai, ka përmasa të tri kontinenteve. Prandaj, pa rënë në përsëritje, mund të themi se I. Kadare, me figurën e Skënderbeut luan me kohët e hapësirat, pra merret me *kozmogoninë* e *kozmografinë* me të cilat krijon një metaforë të madhe, metaforën Skënderbe, e cila i ka shërbyer më vonë për lavdinë e tij letrare.

Pamësia në figuracionin artistik që krijon Kadare, për ta shpjeguar më së miri figurën, është fjala, *shumë*. Për estetët dhe studiuesit, kjo krijon vështirësi, por më edhe shtigje të hapura për studime të mëtejme. Kjo cilësi, pra shumëkuptimësia, është një ndër elementet bazë të veprës së tij, që e radhitë këtë vepër në letërsinë moderne. Është mjet shprehës me të cilin Kadare thyen tradicionalizmin në letërsi. Kështu, brenda një figure artistike gjallërojnë disa figura. Kategoritë estetike janë të përziera brenda një kategorie. Kadare, me këtë veçori thyen skemën. Figura e Skënderbeut, e krijuar nga ai, ngërthen në vete disa kategori estetike: tragjiken, heroiken, të madhërishtmen. Gjithashtu përmban në vetvete të thjeshtën, njerëzoren, të përditshmen, tokësoren. Mjetet stilistike që përdor autori për të krijuar figurën artistike janë të shumta, por kanë një teknikë dhe kahe të kundërt nga tradicionalizmi.

Askund në veprën e Kadaresë, në paraqitjen e figurës së Skënderbeut, nuk gjejmë mjete të traditës, qoftë nga letërsia gojore, qoftë nga ajo e shkruar për portretizimin e heroit. Ndryshe nga tradita, ai nuk e paraqet Skënderbeun si një gjigant, me një shpatë magjike që çan shkëmbinjtë, me kalin që fluturon nga mali në mal etj. Skënderbeu është tokësor, por për kampin armik, ai është legjendë.

Figurën stilistike që përdor Kadare, mund ta interpretosh në disa mënyra. Simbolin që përdor ai; ke të drejtë ta quash metaforë e hiperbolë njëkohësisht. Me epitelin e thjeshtë ose krahasimin e thjeshtë, si figura bazë të poezisë së shekujve, ai, krijon simbolin, metaforën, hiperbolën etj. Për të argumentuar mendimin tonë, le t'u rikthehemi vetëm dy vargjeve, që hapin vjershën e shumëcitur, “*Portreti i Skënderbeut*”: / *Si dit e plotë ai shtjellej / Me re dhe erë mbi Atdhe*./

Vjersha fillon me një lidhës krahasuese “si”. Ky mjet gjuhësor, bashkuar me fjalën ditë, krijon figurën stilistike të krahasimit, dhe kjo është figura më e thjeshtë stilistike. Por te Kadareja, ky krahasim është polivalent, i shumëvlerësuar. Ky krahasim, lirisht komentohej edhe si simbol edhe si metaforë, por edhe si hiperbolë: a) *simbol*, dita-simbol i dritës, shpresës, jetës etj., b) *metaforë*, raporti njeri-ditë, c) *hiperbolë*, dita astronomike, pushton hapësira sa gjysma e rruzullit. Heroi, Skënderbe është “*ditë*”, pra është *qiellor*, kështu del hiperbolë.

Këtë ide e plotëson epiteli vijues *e plotë* dhe folja *shtjellej*, që në vetvete përmban kuptimin metaforik të shqetësimit. Autori nuk thotë shtrihej ose ndriçonte. Fjala *shtjellej* ka përbrenda hall, shqetësim. Shtjellen retë, erërat, ka stuhi, kohë të pazakontë. Dhe këtë, autori e plotëson me tri detaje në vargun pasardhës: *Me re e erë mbi Atdhe*. Retë, era, atdheu, tri elemente, tri detaje artistike që japin hallin, shqetësimin, dramën, luftën dhe e plotësojnë portretin e personazhit. Shembuj të tillë do të ishin të pafund në krijimtarinë e Kadaresë dhe kjo gjë përbën mundësi studimi të veçantë. Simboli, krahasimi etj., janë shembuj ose çelës për të zbërthyer dhe interpretuar artin e Kadaresë, por interpretimi i këtij arti, është sa i lehtë aq edhe i vështirë. Shumëkuptimësia e tij, jep dorë të lirë për interpretime, por krijon vështirësi të shumta. Çfarëdo të thuash për këtë art, diçka mbetet mangut, gjithmonë.

Duke lexuar veprën tërësore të Kadaresë, posaçërisht, ato pjesë vepre që bëjnë fjalë për Skënderbeun, vetiu të lind një pyetje: a përsëriten kohët, a rikthehen ato?! Në mënyrë indirekte çka është thelbësore në veprën e Kadaresë, ai jep një përgjigje të prerë: Po! Kohët rikthehen në mënyra e mendësi të ndryshme. Ndërrojnë vetëm

mjetet. Rikthimi i kohëve, ringjallja e tyre, në optikën e Kadaresë, shfaqet në dy mënyra, me antitezë dhe me kontrast. Mesjeta kthehet në Ballkan në formën e gjakut, dhunës, varreve masive, primitivizmit, të përfaqësuar nga car Dushani, knjaz Llazari etj. Por shfaqet edhe në një mënyrë tjetër, /*Se pas Dushanit, car të friksëhm, / Rrufeshm Skënderbeu mbërrin* /. Pra kohët përsëriten edhe si tragjedi, edhe si komedi, por gjithsesi me gjak. Popuj të ndryshëm, edhe kur s'i kanë pasur heronjtë a eposet i kanë krijuar ata, me fantazinë e tyre. Anglezët, kanë eposin e Robin Hudit. Pa asnjë kompleks, pa asnjë fyerje, në fund të fundit kush ishte Robin Hudi i eposit anglez? Një hero që jetoi në pyll, grabit të pasurit dhe ndihmon të varfrit. Pra një tip social.

Një nga veprat e njerëzimit "*Iliada*", që ishte bërë burim për mijëra vepra letrare gjatë shekujve, kryevepër e kulturës greke, në thelb ka një agresion: grekët dalin jashtë territorit të tyre, sulmojnë për 10 vjet Trojën. Pra, kështu u krijua një epos. Kjo ndodh edhe me shqiptarët. Shekuj para Skënderbeut, ata kishin eposin e tyre legjendar të cilësuar si *Eposi i Kreshnikëve* ose cikli i Mujit e Halilit. Shqiptarët, s'kishin nevojë për lavdi. Shekuj më vonë, krijuan *skënderbejadën*, pra eposin rreth bëmave dhe epokës së Skënderbeut. Jo si nevojë letrare, por si rithirrje e kohës së shkuar në aktualitet. Kohët rikthehen prandaj, herë si butafori e herë si hall kombëtar. U rikthyen deri në qershor të vitit 1999, në Kosovë. Si butafori kthehet në pamjen e agresorit dhe si thirrje, si kujtesë e simbolit të qëndresës e lirisë në figurën e Skënderbeut.

Ky stil i ri, kjo metodë e re e niveleve sipërore që solli Kadare në letërsinë shqipe, mund të veçojmë se, përbën dy shkolla: shkollën studimore, që u shërben e do t'u shërbejë nxënësve, studentëve, studiuesve e estetëve të artit dhe shkollën e artit, që do t'u shërbejë poetëve, shkrimtarëve, njerëzve të fushave, llojeve e gjinive të ndryshme të artit gjithandëj. Kështu ky stil i përdorur, kjo përvojë e Kadaresë e rendit letërsinë shqipe me dinjitet përkrah letërsive tjera bashkëkohore të përgjithshme.

Si përfundim

Po të bëjmë një krahasim të veprës së Dantes madh në kontekst me veprën e Kadaresë dhe strukturën e përrjetshme që krijoi ai, atëherë krahas këtyre duhet përmendur edhe një shkrimtar tjetër të madh të letërsisë botërore, Onore de Balzak, i cili tentoi të bënte atë çka bënte Danteja, por në kahe të kundërta. Hapësira ku i vendos ngjarjet e personazhet e veta është kryesisht Parisi dhe Franca. Gjithashtu, kemi një shkrimtar të tretë të cilit Kadare i referohet në mënyrë të herëpashershme, por jo të drejtpërdrejtë. Është Shekspiri, i cili ngjarjet e kryeveprave të letërsisë së përgjithshme, i zhvillon në hapësira shumë të ngushta, kryesisht brenda mureve të kështjellave.

Sido që të jetë, struktura e veprave të Shekspirit ndihet në gjithë krijimtarinë e Kadaresë. Nëse, Dante, vepron në hapësira të papërcaktuara por të përbotshme, nëse Shekspiri vepron brenda hapësirave shumë të ngushta, kryesisht të kështjellave, nëse Balzaku vepron brenda Francës së tij, Kadare vepron në hapësira të gjëra e të pamata. Ndërkaq, mesazhet e veprave të këtyre gjenive, janë të përafërta. Gjenitë kumtojnë në kohë të papërcaktuar, e thërrasin njeri-tjetrin. Mund të themi prandaj, se Kadare, është në mes të treve përnjëherësh, ose plotësim i tyre, drejtpërdrejt ose në mënyrë analoge.

Prandaj, duke u bazuar në gjithë këtë vepër artistike, mund të themi se në letërsinë shqipe, por edhe në atë botërore, Kadare është unik. Janë të rralla letërsitë, që një autor i tyre i vetëm, të ketë dhënë si Ismail Kadareja për letërsinë e vet. Ai, me krijimtarinë e tij letrare, ka dhënë pothuaj gjithë historinë, në pikat e saj më të qenësishme, kodet morale e zakonore, baladat, legjendat, psikologjinë e kulturën e një populli, në një shtrirje kohore që rrok kohën prej antikitetit e deri më sot. Gjithashtu, ai, arrin ta zbërthejë në mënyrë të veçantë psikologjinë ballkanase dhe nëpërmes kësaj jep mesazhe gjithëballkanike e gjithënjërezore. Me këtë vepër, ai, shpërfaq edhe një dimension tjetër të artit të tij: profecinë a largpamësinë, së bashku me kumtin e mesazhin e gjithmonshëm. Kështu prandaj, si përfundim mund të thuhet se, arti shqiptar përgjithësisht e veçanërisht i Kadaresë, kanë një emër: paqe, mirëkuptim, bashkëfatësi e ardhmëri të përbashkët.

BIBLIOGRAFI

- Dado, F., *Lexuesi në kurth, Estetika e Kadaresë*, Onufri, Tiranë, 2016.
- Kadare, I., *Koha*, Tiranë, 1976.
- Kadare, I., *Vepra*, Onufri, Tiranë, 2009.
- Kadare, I., *Mosmarrëveshja*, Onufri, Tiranë, 2012.
- Ndreca, A., (Përmbledhje e përgatitur) *Kadare, Leximi dhe Interpretimi*, Onufri, Tiranë, 2016.
- Sinani, Sh., *Për proëzn e Kadaresë*, Naimi, Tiranë, 2009.

